



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr.89, datë 18.06.2024

PËR  
VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË ZOTIT ARBËR DELILAJ,  
KANDIDAT PËR MAGJISTRAT PROKUROR, I CILI DO TË DIPLOMOHET NGA  
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS NË VITIN 2024

Mbështetur në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159 dhe 189 pika 1, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 32 dhe 35 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës për magjistrat prokuror zotit Arbër Delilaj, i cili do të diplomohet nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2024”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Relacionit të kandidatit për t’u emëruar prokuror, zoti Arbër Delilaj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të vlerësojë të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatit Arbër Delilaj.
3. Lejimin e kandidatit Arbër Delilaj të vijojë me procedurat e mëtejshme për emërimin e tij si prokuror.
4. Të njoftohet për këtë vendim zoti Arbër Delilaj dhe Shkolla e Magjistraturës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 18.06.2024.



KRYETAR  
Mirela Bogdani

ANËTAR  
Zeqir Hoda

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ANËTAR  
Ledina Riza

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Moisi Duda

**ANËTAR**  
**Vatë Staka**



**ANËTAR**  
**Olger Eminaj**

